



FLETORJA ZYRTARE

E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 128

Tiranë – E premte, 1 shtator 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 30.8.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore (Tirana Agrikulturë)” 15167
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 30.8.2023	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të një pjese të pasurive me nr. 4/53; nr. 4/222; nr. 4/223; nr. 4/296; nr. 4/130; nr. 4/315; nr. 4/652, në zonën kadastrale 8591, Shkodër, dhe për disa shtesa në vendimin nr. 226, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit” 15169
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 30.8.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 514, datë 18.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos–Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, dhe caktimin e Bashkisë Durrës, si njësi zbatuese”, të ndryshuar..... 15178
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 30.8.2023	Për përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit dhe autorizimit, dokumenteve shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë apo autorizim, afatit të vlefshmërisë së licencës dhe autorizimit, procedurave të shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe afateve për kryerjen e tyre, si dhe procedurave të shfuqizimit/pezullimit të licencave e autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e artikujve piroteknikë..... 15178

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 30.8.2023	Për përcaktimin e masës ditore të përfitimit dhe procedurës së kompensimit për strehim për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë.....	15186
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 30.8.2023	Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për transferimin e punonjësve të Gardës së Republikës në struktura të tjera me gradë, në varësi të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.....	15187
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 30.8.2023	Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e zhvillimit të <i>Tirana Expo</i> dhe për një shtesë fondi në buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, miratuar për vitin 2023.....	15187
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 30.8.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave, për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike”.....	15188
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.8.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 359, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për parimet dhe udhëzimet e praktikës së prodhimit të mirë të barnave, për përdorim njerëzor, në Republikën e Shqipërisë”.....	15189
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 30.8.2023	Për transferimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pasurisë së paluajtshme shtetërore nr. 10/46, ish-materniteti Sarandë, në zonën kadastrale 8641.....	15190
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2, datë 1.2.2023	Për elementet, kërkesat dhe parimet e përgjithshme të analizës së kostos dhe përfitimit, për vlerësimin e potencialit të aplikimit të kogjenerimit me efikasitet të lartë, si dhe të ngrohjes e ftohjes efikente	15194
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9, datë 29.5.2023	Për llojin dhe periodicitetin e informacionit që vihet në dispozicion nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë.....	15199
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 478, datë 28.8.2023	Për delegimin e kompetencave.....	15200
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 13220, datë 29.8.2023	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	15200

**VENDIM****Nr. 504, datë 30.8.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I
TREGUT PËR SHITJET ME SHUMICË
DHE PAKICË I PRODUKTEVE
USHQIMORE (TIRANA
AGRIKULTURË)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore (Tirana Agrikulturë)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “vresht”, me një vlerë të përgjithshme prej 3 434 215.68 (tre milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 434 215.68 (tre milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, përballohet nga Bashkia Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Tiranë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrotjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA EMERORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I TREGUT PËR SHITJET ME SHUMICË DHE PAKICË I PRODUKTEVE USHQIMORE (TIRANA AGRIKULTURË)”

Nr. rendor	Të dhënat e pronarit			Të dhënat kadastrale								Të dhënat e shpronësimit			Shënime (kufizime hipotekore barrë mbi pasurinë etj.)
	Emër/atësi/mbiemër			Qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale arë/vresht (m²)	Arë/vresht (m²)	Vol.	Faqe	Sipërfaqja(m²) "arë/vresht"	Çmimi (lek/m²)	Vlera totale (lek)	
1	DASHAMIR NAILE XHEVRRIJE	BESIM SEFER MURAT	LECI LECI LECI	TIRANË	1604	404/89	Arë	208	208	14	229	114.87	448	51,461.76	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	BANKA CREDINS			TIRANË	1604	404/33	Arë	4000	4000	8	222	827.00	448	370,496.00	Seksioni C ky regjistrim anulon regjistrimin me numër dokumenti 00002189, bie rivlerësimi në vlerën 29.702.400 lekë aplikimi nr. 17508, dt. 24.7.2020, seksioni E- kjo pasuri u përmirësua/ përditësua me ref. 00002776. Kjo sipërfaqe me AMTP përkon me emërtimin popullor fusha.3.
3	BANKA CREDINS			TIRANË	1604	404/44	Arë	3000	3000	9	70	1285.49	448	575,899.52	Seksioni E: kjo sipërfaqe në AMTP përkon me emërtimin popullor Rzali i sipërm nr. 304. Kjo pasuri u përmirësua/ përditësua me ref. 00002787 25
4	BANKA CREDINS			TIRANË	1604	404/49	Arë	4700	4700	11	108	152.80	448	68,454.40	Seksioni E: kjo sipërfaqe në AMTP përkon me emërtimin popullor fusha. Kjo pasuri u përmirësua/ përditësua me ref. 00002792 21
5	FLORA PETRIT	MEHMET MEHMET	ZENELAJ LECI	TIRANË	1604	404/41	Arë	1400	1400	9	67	1400.00	448	627,200.00	Seksioni E: kjo sipërfaqe në AMTP përkon me emërtimin popullor ferra e zallit nr. 296. Kjo pasuri u përmirësua/ përditësua me ref. 00002784 18
6	RAMAZAN	SAID	LECI	TIRANË	1604	404/2	Vresht	4000	4000	2	180	3885.50	448	1,740,704.00	Seksioni E: kjo sipërfaqe në AMTP përkon me emërtimin popullor fusha e gunës. Kjo pasuri u përmirësua/ përditësua me ref. 00002763 1
TOTALI												7665.66		3,434,215.68	

1. Për tokën bujqësore, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste janë bazuar në të dhënat e marra nga konfirmimi i Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Rurale 1 me kërkesën nr. 10899, datë 8.3.2023, dhe AV0 22049, datë 19.4.2023.



VENDIM
Nr. 505, datë 30.8.2023

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TE DREJTORIA E
PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR TË NJË PJESE
TË PASURIVE ME NR. 4/53; NR. 4/222;
NR. 4/223; NR. 4/296; NR. 4/130; NR. 4/315;
NR. 4/652, NË ZONËN KADASTRALE
8591, SHKODËR, DHE PËR DISA SHITESA
NË VENDIMIN NR. 226, DATË 23.4.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË
TRANSPORTIT RRUGOR, TË CILAT I
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
TRANSPORTIT DHE TË
TELEKOMUNIKACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me

propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të një pjese të pasurive me nr. 4/53; nr. 4/222; nr. 4/223; nr. 4/296; nr. 4/130; nr. 4/315; nr. 4/652, në zonën kadastrale 8591, Shkodër, sipas formularit për inventarizimin dhe planeve të rlevimit që i bashkëlidhen këtij vendimi, për ndërtimin e “Terminalit të autobusëve ndërqytetës Shkodër”.

2. Në listën e inventarit të pronave, të miratuar me vendimin nr. 226, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, shtohen edhe pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																									
PRONARI: SHTET		DATE: 06.06.2023		QELLI: KALIM_NË PËRGJEGJËSI_ADMINISTRIMI_TË_DPSHTRR																																					
VENDNDODHJA BASHKIA: SHKODER DVASHK: SHKODER ZONA KADASTRALE: 8591 NUMRI PASURISE: 4/53 INDEX HARTE: SH.O-5 TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: TRUALL SIP.PASURISE = 1674.0 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT ____ m2 NUMRI KATEVE ____																																									
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																									
X 458296 Y 4658520 X 458433 Y 4658520 SHPJEGUES PASURIA 4/53, TRUALL, SIP. = 1674.0 m2 P1 NGA PASURIA 4/53, SIP. = 1200.2 m2 SIPERFAQE PER KALIM NE ADM, SIP. = 1200.2 m2																																									
X 458296 Y 4658520 SH 1:500 X 458433 Y 4658520																																									
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; font-size: 0.8em;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/282</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUG</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/223</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/315</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/131</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>							Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI		NATYRAL	4/282			2	JUG		NATYRAL	4/223			3	LINDJE		NATYRAL	4/315			4	PERENDIM		NATYRAL	4/131		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																			
1	VERI		NATYRAL	4/282																																					
2	JUG		NATYRAL	4/223																																					
3	LINDJE		NATYRAL	4/315																																					
4	PERENDIM		NATYRAL	4/131																																					
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: SOKOL ISMAILI LICENCA: NR. K.2077 DATE: 06.06.2023 KOMPANI: Ing. Sokol ISMAILI NIPT: 000000000000000000 NENSHKRIMI/VULA: REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI: _____ DVASHK: _____ NENSHKRIMI: _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI: _____ NENSHKRIMI / VULA: _____ TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Kode per teknologji e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NENSHKRIMI: _____																																									
Kode per teknologji e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																									



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																									
PRONARI: SHTET		DATE: 06.06.2023		QELLIMI: KALIM_NË PËRGJEGJËSI_ADMINISTRIMI_TË_DPSHTRR																																					
VENDNDODHJA BASHKIA: SHKODER DVASHK: SHKODER ZONA KADASTRALE: 8591 NUMRI PASURISE: 4/130 INDEX HARTE: SH:O-5 TE DHENAT E PASURISE SIP.PASURISE = 332.0 m² SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT ____ m² NUMRI KATEVE ____ LLOJI PASURISE: KANAL																																									
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																									
X 458324 Y 4658447 SH 1:500 X 458461 Y 4658447 SHPJEGUES PASURIA 4/130, KANAL, SIP. = 332.0 m² P1 NGA PASURIA 4/130, SIP. = 118.1 m² SIPERFAQE PER KALIM NE ADM, SIP. = 118.1 m²																																									
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; font-size: 0.8em;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/223</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUG</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/222</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/133</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/193</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>							Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI		NATYRAL	4/223			2	JUG		NATYRAL	4/222			3	LINDJE		NATYRAL	4/133			4	PERENDIM		NATYRAL	4/193		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																			
1	VERI		NATYRAL	4/223																																					
2	JUG		NATYRAL	4/222																																					
3	LINDJE		NATYRAL	4/133																																					
4	PERENDIM		NATYRAL	4/193																																					
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: SOKOL ISMAILI LICENCA NR. K.2077 DATE: 06.06.2023 KOMPANIA: Ing. Sokol ISMAILI NIPT: 1000000000000000000 NENSHKRIMI/VULA: REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI: _____ DVASHK: _____ NENSHKRIMI: _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI: _____ NENSHKRIMI / VULA: _____ TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____ PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NENSHKRIMI: _____																																									
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																									



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATE: 06.06.2023		QELIMI: KALIM_NË PËRGJEGJËSI_ADMINISTRIMI_TË_DPSHTRR																																				
VENDNDODHJA BASHKIA: SHKODER DVASHK: SHKODER ZONA KADASTRALE: 8591 NUMRI PASURISE: 4/222 INDEX HARTE: SH;O-5 TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: TRUALL SIP.PASURISE = 1350.0 m² SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT ____ m² NUMRI KATEVE ____																																								
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
X 458339 Y 4658462 X 458476 Y 4658462 SHPJEGUES PASURIA 4/222, TRUALL, SIP. = 1350.0 m² P1 NGA PASURIA 4/222, SIP. = 284.3 m² SIPERFAQE PER KALIM NE ADM, SIP. = 284.3 m²																																								
8591 SHKODER		SH 1:500																																						
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; font-size: 0.8em;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/130</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUG</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/296</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/133</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/130</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI		NATYRAL	4/130			2	JUG		NATYRAL	4/296			3	LINDJE		NATYRAL	4/133			4	PERENDIM		NATYRAL	4/130		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI		NATYRAL	4/130																																				
2	JUG		NATYRAL	4/296																																				
3	LINDJE		NATYRAL	4/133																																				
4	PERENDIM		NATYRAL	4/130																																				
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: SOKOL ISMAILI LICENCA: NR. K.2077 DATE: 06.06.2023 KOMPANIA: Ing. Sokol ISMAILI NIPT: 1000000000000000000 NENSHKRIMI/VULA:			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologji e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____																																					
REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI: _____ DVASHK: _____ NENSHKRIMI: _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI: _____ NENSHKRIMI / VULA: _____			PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NENSHKRIMI: _____																																					
Kode per teknologji e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																									
PRONARI: SHTET		DATE: 06.06.2023		QELLIMI: KALIM_NË PËRGJEGJËSI_ADMINISTRIMI_TË_DPSHTRR																																					
VENDNDODHJA BASHKIA: SHKODER DVASHK: SHKODER ZONA KADASTRALE: 8591 NUMRI PASURISE: 4/223 INDEX HARTE: SH/O-5 TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: TRUALL SIP.PASURISE = 4893.0 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT ____ m2 NUMRI KATEVE ____																																									
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																									
SH 1:500 SHPJEGUES PASURIA 4/223, TRUALL, SIP. = 4893.0 m2 P1 NGA PASURIA 4/223, SIP. = 2666.2 m2 SIPERFAQE PER KALIM NE ADM, SIP. = 2666.2 m2																																									
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; font-size: 0.8em;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/53</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUG</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/130</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/133</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/131</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>							Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI		NATYRAL	4/53			2	JUG		NATYRAL	4/130			3	LINDJE		NATYRAL	4/133			4	PERENDIM		NATYRAL	4/131		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																			
1	VERI		NATYRAL	4/53																																					
2	JUG		NATYRAL	4/130																																					
3	LINDJE		NATYRAL	4/133																																					
4	PERENDIM		NATYRAL	4/131																																					
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: SOKOL ISMAILI LICENCA: NR. K/2077 - DATE: 06.06.2023 KOMPANIA: Ing. Sokol Ismaili SHQIPTARE NIPT: 000000000000000000 NENSHKRIMI/VULA: REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI: _____ DVASHK: _____ NENSHKRIMI: _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI: _____ NENSHKRIMI / VULA: _____ TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologji e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____ PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NENSHKRIMI: _____																																									
Kode per teknologji e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																									



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: SHTET		DATE: 06.06.2023		QELIMI: KALIM_NË PËRGJEGJËSI_ADMINISTRIMI_TË_DPSHTRR		
VENDNDODHJA BASHKIA: SHKODER DVASHK: SHKODER ZONA KADASTRALE: 8591 NUMRI PASURISE: 4/296 INDEX HARTE: SH;O-5 TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: TRUALL SIP.PASURISE = 2505.0 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT ____ m2 NUMRI KATEVE ____						
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE						
X 458329 Y 4658424 X 458466 Y 4658424 SHPJEGUES PASURIA 4/296, TRUALL, SIP. = 2505.0 m2 P1 NGA PASURIA 4/296, SIP. = 30.4 m2 SIPERFAQE PER KALIM NE ADM, SIP. = 30.4 m2						
X 458329 Y 4658328 SH 1:500 X 458466 Y 4658328						
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI		NATYRAL	4/222		
2	JUG		NATYRAL	4/221		
3	LINDJE		NATYRAL	4/54		
4	PERENDIM		NATYRAL	4/130		
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: SOKOL ISMAILI LICENCA: NR. K.2077 DATE: 06.06.2023 KOMPANIA: Ing. Sokol Ismaili NIPT: 1201200000000000000 NENSHKRIMI/VULA: REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI: _____ DVASHK: _____ NENSHKRIMI: _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI: _____ NENSHKRIMI / VULA: _____ TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____ PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NENSHKRIMI: _____						
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale						



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATE: 06.06.2023		QELLIMI: KALIM_NË PËRGJEGJËSI_ADMINISTRIMI_TË_DPSHTRR																																				
VENDNDODHJA BASHKIA: SHKODER DVASHK: SHKODER ZONA KADASTRALE: 8591 NUMRI PASURISE: 4/315 INDEX HARTE: SH;O-5 TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: KANAL SIP.PASURISE = 898.0 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT ____ m2 NUMRI KATEVE ____																																								
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
X 458330 Y 4658429 X 458467 Y 4658525 8591 SHKODER SH 1:500 SHPJEGUES PASURIA 4/315, TRUALL, SIP. = 898.0 m2 P1 NGA PASURIA 4/315, SIP. = 107.9 m2 SIPERFAQE PER KALIM NE ADM, SIP. = 107.9 m2																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; font-size: 0.8em;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/107</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUG</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/133</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/271, 4/50</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/53, 4/282</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI		NATYRAL	4/107			2	JUG		NATYRAL	4/133			3	LINDJE		NATYRAL	4/271, 4/50			4	PERENDIM		NATYRAL	4/53, 4/282		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI		NATYRAL	4/107																																				
2	JUG		NATYRAL	4/133																																				
3	LINDJE		NATYRAL	4/271, 4/50																																				
4	PERENDIM		NATYRAL	4/53, 4/282																																				
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: SOKOL ISMAILI LICENCA: NR. K.2077 DATE: 12/06/2023 KOMPANIA: <u>Ing. Sokol ISMAILI</u> NIPT: <u>12225 K.2077</u> NENSHKRIMI/VULA: <u>Projektim Zbatim</u> REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI: _____ DVASHK: _____ NENSHKRIMI: _____ KONFIRMOI PERGJEGJES/DREJTORI: _____ NENSHKRIMI / VULA: _____ TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologji e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____ PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NENSHKRIMI: _____																																								
Kode per teknologji e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI: SHTET		DATE: 06.06.2023		QELLIMI: KALIM_NË PËRGJEGJËSI_ADMINISTRIMI_TË_DPSHTRR																																				
VENDNDODHJA BASHKIA: SHKODER DVASHK: SHKODER ZONA KADASTRALE: 8591 NUMRI PASURISE: 4/652 INDEX HARTE: SH;O-5 TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: KANAL SIP.PASURISE = 402.0 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT ____ m2 NUMRI KATEVE ____																																								
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE																																								
X 458349 Y 4658490 X 458486 Y 4658490 SHPJEGUES PASURIA 4/652, TRUALL, SIP. = 402.0 m2 P1 NGA PASURIA 4/652, SIP. = 176.7 m2 SIPERFAQE PER KALIM NE ADM, SIP. = 176.7.2 m2																																								
SH 1:500																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; font-size: 0.8em;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>ORIENTIMI</th> <th>PERDORIMI</th> <th>TIPI KUFIRIT</th> <th>KUFITARI</th> <th>ID/NIPT</th> <th>SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/315</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUG</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/157</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/52, 4/51</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td>NATYRAL</td> <td>4/130, 4/223, 4/222</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI		NATYRAL	4/315			2	JUG		NATYRAL	4/157			3	LINDJE		NATYRAL	4/52, 4/51			4	PERENDIM		NATYRAL	4/130, 4/223, 4/222		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI		NATYRAL	4/315																																				
2	JUG		NATYRAL	4/157																																				
3	LINDJE		NATYRAL	4/52, 4/51																																				
4	PERENDIM		NATYRAL	4/130, 4/223, 4/222																																				
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT EMRI: SOKOL ISMAILI LICENCA: NR. K.2077 DATE: 06.06.2023 KOMPANIA: SOKOL ISMAILI LICENCA: K.2077 NENSHKRIMI/VULA: Projektim Zbatues REALIZOI PER ASHK SPECIALISTI _____ DVASHK _____ NENSHKRIMI _____ KONFIRMOI PERGJEGJESI/DREJTORI _____ NENSHKRIMI / VULA _____ TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: _____ PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ NENSHKRIMI _____																																								
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



1.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bankila : 1 Shkodër

Fusha e përdorimit të Pronës: Terminali i Autobuzave Ndërqytell

Nr. Rend.	A		Lloji i Pronës	B		C	Funksionet për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me kompetencë administrative	Te dhëna të tjera (Shënimet e veçanta)		
	Zona Kadasir. & Indeks i Hartes	Nr. Pasurisë		Sip. Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip. Totale: Kalim në Përgjigje të Administrimit të DPSHTRR					Nga Sip. Totale: 0	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	12	
1	8591 SH-O-5	4/223	Trull	SH-TET Shkodër	4893	2668.2	0	Terminali i Autobuzave Ndërqytell	DPSHTRR	DPSHTRR	Resulton se ka ndërtim pa leje
2	8591 SH-O-5	4/53	Trull	SH-TET Shkodër	1674	1200.2	0	Terminali i Autobuzave Ndërqytell	DPSHTRR	DPSHTRR	
3	8591 SH-O-5	4/222	Trull	SH-TET Shkodër	1950	284.3	0	Terminali i Autobuzave Ndërqytell	DPSHTRR	DPSHTRR	
4	8591 SH-O-5	4/236	Trull	SH-TET Shkodër	2505	30.4	0	Terminali i Autobuzave Ndërqytell	DPSHTRR	DPSHTRR	
5	8591 SH-O-5	4/130	Kanal	SH-TET Shkodër	332	118.1	0	Terminali i Autobuzave Ndërqytell	DPSHTRR	DPSHTRR	
6	8591 SH-O-5 / N-5	4/315	Kanal	SH-TET Shkodër	886	107.9	0	Terminali i Autobuzave Ndërqytell	DPSHTRR	DPSHTRR	
7	8591 SH-O-5 / P-5	4/652	Kanal	SH-TET Shkodër	402	176.7	0	Terminali i Autobuzave Ndërqytell	DPSHTRR	DPSHTRR	
						4563.8					

Identifikues: Sokol Ismaili Ing.
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizori: Sokol Ismaili Ing.
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Approvot: Blendi Goxhija Drejtor DPSHTRR
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, let. firmë, vlerë)

Stampa: DPSHTRR, SHKODËR, 12.05.2017

**VENDIM****Nr. 506, datë 30.8.2023**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 514, DATË 18.9.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E ZBATIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT PËR REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO-ROMANOS-KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT, DHE CAKTIMIN E BASHKISË DURRËS, SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 514, datë 18.9.2021, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2 Bashkisë Durrës, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi, në masën 892 511 312.6 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e dymbëdhjetë pikë gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023 dhe i transferohet Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 509, datë 30.8.2023**

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË POSAÇME TË LICENCIMIT DHE AUTORIZIMIT, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE, QË PARAQITEN PËR PAJISJEN ME LICENCË APO AUTORIZIM, AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË LICENCËS DHE AUTORIZIMIT, PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT E TË VENDIMARRJES DHE AFATEVE PËR KRYERJEN E TYRE, SI DHE PROCEDURAVE TË SHFUQIZIMIT/PEZULLIMIT TË LICENCAVE E AUTORIZIMEVE PËR PRODHIMIN, IMPORTIMIN, EKSPORTIMIN, TRANSITIMIN E ARTIKUJVE PIROTEKNIKË

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 25, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
KUSHTET E POSAÇME TË LICENCIMIT
DHE AUTORIZIMIT

Neni 1

Kushtet e posaçme të licencimit për import ose eksport të artikujve piroteknikë

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve është institucioni përgjegjës që lëshon licencat e importit, eksportit dhe të prodhimit të artikujve piroteknikë, si dhe autorizimet për importin,



eksportin, transitin e artikujve piroteknikë për operatorët ekonomik kërkuar.

2. Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me licencë për import ose eksport të artikujve piroteknikë, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë në objektin e aktivitetit veprimtarinë e importit/eksportit të artikujve piroteknikë;

b) të ketë të instaluar dhe funksionale sistemet për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin për ambientet e magazinimit;

c) të ketë në ruajtje fizike ambientet e magazinimit të artikujve piroteknikë, me një shoqëri të licencuar për shërbimin privat të sigurisë fizike;

ç) të ketë drejtues teknik, i cili është përgjegjës për çështjet e sigurimit teknik, trajnimit të personelit me rregullat e sigurimit teknik. Drejtuesi teknik duhet të jetë i pajisur me dëshmi zjarrmëtarit, lëshuar nga organi përgjegjës në ministrinë që mbulon çështjet e industrisë dhe të energjetikës;

d) punonjësit e angazhuar për nevojat e operatorit ekonomik të plotësojnë kushtet e aftësisë shëndetësor, trajnimit, sipas kërkesave të nenit 17, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”;

dh) personeli përgjegjës për magazinimin, asgjësimin e artikujve piroteknikë duhet të jetë i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nga organi përgjegjës në ministrinë që mbulon çështjet e industrisë dhe të energjetikës;

e) administratori, ortaku dhe punonjësit e angazhuar duhet të gëzojnë besueshmëri për ushtrimin e aktivitetit me lëndët piroteknike, e cila vërtetohet nga dokumenti i besueshmërisë që përpilohet nga struktura e Policisë së Shtetit, ku shtetasi ka vendbanimin, në bazë të kërkesës së bërë nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve;

ë) administratori, ortaku dhe punonjësit e angazhuar të operatorit ekonomik nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale.

Neni 2

Kushtet e licencimit për prodhimin e artikujve piroteknikë

1. Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me licencë për prodhimin e artikujve piroteknikë, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë në objektin e aktivitetit veprimtarinë e prodhimit të artikujve piroteknikë;

b) t'i jetë nënshtruar procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe të jetë i pajisur me vendim për vlerësimin e ndikimit në mjedis/deklaratë mjedisore që në fazën e projektidesë, si dhe të sigurojë lejet përkatëse mjedisore për prodhimin e artikullit piroteknik, përpara vënies në punë të instalimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit;

c) të ketë në pronësi ose përdorim objektin ku do të ushtrojë veprimtarinë e prodhimit dhe magazinimit të artikujve piroteknikë;

ç) të përcaktojë projektin teknologjik të prodhimit, i cili duhet të jetë i miratuar nga një inxhinier projektues i licencuar dhe me eksperiencë në projektimin e linjave teknologjike;

d) të ketë të instaluar dhe funksionale sistemet për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin për ambientet e prodhimit dhe magazinimit;

dh) të ketë në ruajtje fizike ambientet e prodhimit e të magazinimit me një shoqëri të licencuar për shërbimin privat të sigurisë fizike;

e) punonjësit e angazhuar për nevojat e operatorit ekonomik të plotësojnë kushtet e aftësisë shëndetësor, trajnimit, sipas kërkesave të nenit 17, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”;

ë) administratori, ortaku dhe punonjësit e angazhuar duhet të gëzojnë besueshmëri për ushtrimin e aktivitetit me lëndët piroteknike, i cili vërtetohet nga dokumenti i besueshmërisë që përpilohet nga struktura e Policisë së Shtetit, ku shtetasi ka vendbanimin, në bazë të kërkesës së bërë nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve;

f) administratori, ortaku dhe punonjësit e angazhuar nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale;

g) për produktet, të cilat kërkon të prodhojë, duhet të kryejë pranë një organizmi evropian të notifikuar procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë së artikujve piroteknikë, duke ndjekur njërin nga procedurat e parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”;

gj) të ketë të punësuar drejtues teknik me kohë të plotë pune, që të jetë i regjistruar në ekstraktin e QKB-së, i cili duhet:

i. të ketë arsimin e lartë të nivelit “Master i shkencave” apo ekuivalent me të, në inxhinieri kimie ose kimi industriale, ose të ketë përfunduar arsimin e lartë të nivelit “Master i shkencave” apo ekuivalent



me të, në fusha akademike ushtarake, me profil në njërin nga këto degë: kimi, armatim, municion, forca xheniere, piroteknikë, lëndë plasëse ose lëndë piroteknike;

ii. të ketë përvojë pune dyvjeçare në fushën e prodhimit të artikujve piroteknikë ose të jetë trajnuar e certifikuar pranë një subjekti prodhues për artikuj piroteknikë, brenda ose jashtë vendit, provuar me librezën e punës;

iii. të vërtetojë me raport mjekësor që është i aftë nga ana mendore e fizike;

iv. të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë nga organet përgjegjëse të Policisë së Shtetit;

v. të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;

vi. të jetë i pajisur me certifikatë trajnimi për kryerjen e kursit të trajnimit për zjarrfikës me rrezik të lartë pranë Akademisë së Sigurisë, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin;

h) të ketë të miratuar rregulloren e sigurimit teknik, hartuar nga drejtuesi teknik, ku përcaktohen kushtet e sigurisë, trajnimi i punonjësve, masat për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve dhe mjedisit gjatë prodhimit, magazinimit, asgjësimit dhe testimit të produkteve piroteknike, si dhe identifikimi i rreziqeve, kompensimi i rrezikut nga zjarri, menaxhimi i emergjencave, me qëllim zbutjen e rrezikut të mbetur, nëpërmjet organizimit dhe menaxhimi i ekipeve të sigurisë në drejtim të masave parandaluese dhe mbrojtëse, me referencë të veçantë ndaj sjelljes së zjarrit të strukturave (REI);

i) të mos punësojë punonjës të patrajnuar nga drejtuesi teknik, lidhur me sigurinë në punë, të cilëve u matet efektiviteti i trajnimeve nëpërmjet testeve para marrjes në punë dhe monitorimeve periodike gjatë periudhës së marrëdhënieve të punës;

j) personeli përgjegjës për magazinimin, asgjësimin dhe testimin e artikujve piroteknikë duhet të jetë i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nga organi përgjegjës në ministrinë që mbulon çështjet e industrisë dhe të energjetikës.

Neni 3

Kushtet për pajisjen me autorizim për import ose eksport të artikujve piroteknikë

1. Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për import ose eksport të artikujve

piroteknikë, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë i pajisur me licencën përkatëse për import ose eksport të artikujve piroteknikë;

b) artikujt piroteknikë që kërkon të importojë apo eksportojë duhet të jenë të pajisur me një nga modulet e parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”;

c) të ketë të nënshkruar një kontratë të vlefshme apo urdhërporosi;

ç) të jetë i pajisur me autorizim për magazinim të artikujve piroteknikë, lëshuar nga struktura përgjegjëse në Policinë e Shtetit.

2. Pas plotësimit të kushteve të përgjithshme të licencimit të prodhimit, sipas nenit 2, të këtij kreu, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, me qëllim kryerjen e procedurave të vlerësimit të përputhshmërisë, merr vendim për të lejuar prodhimin vetëm për nevoja testimi, deri në pajisjen nga një organizëm evropian, i notifikuar me certifikatat e vlerësimit të përputhshmërisë, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”.

Neni 4

Kushtet e licencimit për pajisjen me autorizim për transitin e artikujve piroteknikë

1. Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për transitin e artikujve piroteknikë, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë një kontratë të vlefshme për shërbimin e transportit me shoqërinë transportuese ose të dhënat e transportuesit;

b) malli që kërkon të transitojë duhet të ketë leje eksporti nga vendi eksportues dhe/ose licencat ose lejet e importit nga vendi importues. Në rast se këto dokumente nuk lëshohen në vendet e huaja, operatori ekonomik, që kërkon autorizim transiti, duhet të bëjë një vetëdeklarim, ku të përcaktojë subjektet eksportuese dhe importuese, si dhe përdoruesin e fundit të artikujve piroteknikë;

c) të ketë të përcaktuar të dhëna për mjetet e transportit, periudhën kohore të transimit, itinerarin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pikën doganore hyrëse dhe pikën doganore dalëse.



KREU II
DOKUMENTET SHOQËRUESE QË
PARAQITEN PËR PAJISJEN ME LICENCË
APO AUTORIZIM

Neni 5

**Dokumentet për pajisjen me licencë për
import ose eksport**

1. Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me licencë për import ose eksport të artikujve piroteknikë, duhet të paraqesë pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dokumentet e mëposhtme:

a) vërtetimin nga prokuroria, që shoqëria, administratori, ortakun dhe punonjësit e angazhuar të operatorit ekonomik nuk janë në procedim penal;

b) vërtetimin, që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë;

c) vërtetimin nga Shërbimi Përmbarimor Shtetëror, që shoqëria dhe administratori nuk kanë detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë ose shtetërorë;

ç) vërtetimin nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve;

d) autorizimin për magazinimin e artikujve piroteknikë, ku të jetë përcaktuar specifikisht kapaciteti mbajtës për artikujt piroteknikë, lëshuar nga strukturat përgjegjëse në Policinë e Shtetit;

dh) dokumentacionin tekniko-ligjor për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, projektin e miratuar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe certifikatën e sigurisë nga zjarri për ambientet e magazinimit, lëshuar nga drejtoria ose sektori i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në bashkinë përkatëse;

e) kontratën e shërbimit për ruajtjen fizike të ambienteve të magazinimit të artikujve piroteknikë me një shoqëri të licencuar për shërbimin privat të sigurisë fizike, ku të jenë të parashikuara rregullat e ruajtjes e të sigurimit të magazinave dhe objekteve të tjera të aktivitetit;

ë) kontratën me drejtuesin teknik, i cili është përgjegjës për çështjet e sigurimit teknik, trajnimit të personelit me rregullat e sigurimit teknik. Drejtuesi teknik duhet të jetë i pajisur me dëshmi zjarrmëtar, lëshuar nga autoriteti përgjegjës për çështjet minerare;

f) vetëdeklarimin për punonjësit e angazhuar për nevojat e operatorit ekonomik, që plotësojnë kushtet e aftësimin shëndetësor, trajnimit, sipas kërkesave të nenit 17, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”;

g) vërtetimin e besueshmërisë për administratorin, ortakun dhe punonjësit e angazhuar;

gj) vetëdeklarimin e administratorit, ortakut dhe punonjësve të angazhuar, me anë të cilit japin aprovimin për verifikimin në regjistrin e gjendjes gjyqësore. Certifikata e gjendjes gjyqësore për administratorin, ortakun dhe punonjësit e angazhuar, të cilët nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale, nxirret nga administrata e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Neni 6

**Dokumentet për pajisjen me licencë për
prodhimin e artikujve piroteknikë**

1. Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me licencë për prodhimin e artikujve piroteknikë, duhet të paraqesë pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dokumentet e mëposhtme:

a) vërtetimin nga prokuroria që shoqëria dhe administratori nuk janë në procedim penal;

b) vërtetimin që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë;

c) vërtetimin nga përmbarimi që shoqëria dhe administratori nuk kanë detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë ose shtetërorë;

ç) vërtetimin nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve;

d) vendimin për vlerësimin e ndikimit në mjedis, deklaratë mjedisore dhe lejen përkatëse mjedisore për prodhimin e artikullit piroteknik;

dh) lejen e ndërtimit, shoqëruar me projektin e ndërtimit për prodhimin e artikujve piroteknikë, si dhe dokumentacionin e pronësisë ose kontratën e përdorimit të ambienteve që do të përdorë për prodhim;

e) projektin teknologjik të prodhimit, i cili duhet të jetë i miratuar nga një inxhinier projektues i licencuar dhe me eksperiencë në projektimin e linjave teknologjike;

ë) aktin teknik dhe projektin për mbrojtjen nga zjarri e shpëtimin për mjediset ku do të magazinohen dhe do të prodhohen artikujt



piroteknikë, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes nga zjarri si brenda dhe jashtë ambienteve të prodhimit e të magazinimit;

f) planveprimin dhe dokumentacionin për kushtet e sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve e të stafit, të miratuar nga drejtuesi teknik;

g) kontratën për ruajtjen e ambienteve të prodhimit e të magazinimit me një shoqëri të licencuar për shërbimin privat të sigurisë fizike, ku të jenë parashikuar rregullat e ruajtjes e të sigurimit të objektit për magazinimin e artikujve piroteknikë;

gj) autorizimin për magazinimin e artikujve piroteknikë, lëshuar nga autoritetet shtetërore, sipas parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr. 73/2021;

h) vetëdeklarimin për punonjësit e angazhuar për nevojat e operatorit ekonomik, që plotësojnë kushtet e aftësisë shëndetësor, trajnimit, sipas kërkesave të nenit 17, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”;

i) vërtetimin e besueshmërisë për administratorin, ortakun dhe punonjësit e angazhuar;

j) vetëdeklarimin e administratorit, ortakut dhe punonjësve të angazhuar, me anë të cilit jepet aprovimi për verifikimin në regjistrin e gjendjes gjyqësore. Certifikata e gjendjes gjyqësore për administratorin, ortakun dhe punonjësit e angazhuar, të cilët nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale, nxirret nga administrata e AKSHE-së;

k) certifikatën e vlerësimit të përputhshmërisë të artikujve piroteknikë, duke ndjekur njërin nga procedurat e mëposhtme, të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”;

l) kontratën e punësimit me drejtuesin teknik, ku të jenë të përcaktuara detyrat e drejtuesit teknik në lidhje me sigurinë në punë dhe sigurimin e prodhimit;

ll) certifikatën e trajnimit për drejtuesin teknik për kryerjen e kursit të trajnimit për zjarrfikës me rrezik të lartë pranë Akademisë së Sigurisë, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin;

m) rregulloren e sigurimit teknik, ku përcaktohen kushtet e sigurisë e shëndetit të punonjësve dhe mjedisit gjatë prodhimit, magazinimit, asgjësimit dhe testimit të produkteve piroteknike, si dhe identifikimin e rreziqeve, kompensimin e rrezikut nga zjarri, menaxhimin e emergjencave, me qëllim zbutjen e rrezikut të mbetur, nëpërmjet organizimit

dhe menaxhimit të ekipeve të sigurisë në drejtim të masave parandaluese dhe mbrojtëse, me referencë të veçantë ndaj sjelljes së zjarrit të strukturave (REI);

n) vetëdeklarimin nga operatori ekonomik se kimikatet, që do të përdoren si lëndë e parë për prodhimin e artikujve piroteknikë, duhet të jenë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Neni 7

Dokumentet për pajisjen me autorizim për import ose eksport

1. Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për import ose eksport të artikujve piroteknikë, duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

a) dokumentacionin e origjinës së mallit me llojet dhe sasi të artikujve piroteknikë nga fabrika prodhuese, si dhe faturën e mallit të shoqëruar me listën e paketimit;

b) dokumentacionin me të dhënat teknike të përbërjes së artikujve piroteknikë, emërtimin e tyre, kodin përkatës të shoqëruara me fotografi;

c) deklaratën e përputhshmërisë lëshuar nga prodhuesi, si dhe dokumentacionin për përmbushjen e procedurave për vlerësimin e përputhshmërisë të artikujve piroteknikë, duke paraqitur një nga modulet e parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”;

ç) kopjen e kontratës së shërbimit të transportit me shoqërinë transportuese, nëse ka, ose të dhënat e transportuesit;

d) kopjen e kontratës ose urdhrit të porosisë me subjektin e huaj;

dh) deklaratën e përdoruesit të fundit nga subjekti i huaj importues, në rastet e autorizimit për eksport;

e) deklaratën për gjendjen e magazinës për sasinë e artikujve piroteknikë që disponon.

Neni 8

Dokumentet për pajisjen me autorizim për transitin e artikujve piroteknikë

1. Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për transitin e artikujve piroteknikë, duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:



a) dokumentacionin e origjinës së mallit me llojet dhe sasitë e artikujve piroteknikë nga fabrika prodhuese ose eksportuese, si dhe faturën e mallit të shoqëruar me listën e paketimit;

b) dokumentacionin me të dhënat teknike të përbërjes së artikujve piroteknikë;

c) kopjen e kontratës së shërbimit të transportit me shoqërinë transportuese, nëse ka, ose të dhënat e transportuesit;

ç) licencat ose lejet e eksportit nga vendi eksportues dhe/ose licencat ose lejet e importit nga vendi importues. Në rast se këto dokumente nuk lëshohen në vendet e huaja, operatori ekonomik, që kërkon autorizim transiti, duhet të bëjë një vetëdeklarim, ku të përcaktojë subjektet eksportuese dhe importuese, si dhe përdoruesin e fundit të artikujve piroteknikë;

d) të dhëna për mjetet e transportit, periudhën kohore të transitit, itinerarin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pikën doganore hyrëse dhe pikën doganore dalëse.

Neni 9

Vlefshmëria e dokumentacionit

1. Dokumentacioni ligjor, i paraqitur nga operatorët ekonomikë për t'u pajisur me licencë prodhimi, importi ose eksporti i artikujve piroteknikë, i përcaktuar në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të këtij kreu, duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente, brenda 3 muajve të fundit nga data e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me licencë.

2. Për dokumentacionin, i cili lëshohet me afat të caktuar vlefshmërie në funksion të licencës/autorizimit, operatori ekonomik ka detyrimin e rinovimit të tij, sipas legjislacionit në fuqi dhe paraqitjen e dokumentit të rinovuar, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

Neni 10

Shfuqizimi i licencave/autorizimeve

Në rastet kur operatorit ekonomik nuk i miratohet nga organet përgjegjëse rinovimi i dokumenteve, të përcaktuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të këtij kreu, të cilat lëshohen me afat të caktuar, licencat e prodhimit, importit ose eksportit të artikujve piroteknikë ose autorizimet përkatëse shfuqizohen.

KREU III

PROCEDURAT E SHQYRTIMIT E TË VENDIMMARRJES DHE AFATET PËR KRYERJEN E TYRE

Neni 11

Procedura standarde e shqyrtimit dhe vendimmarrjes për licencim

1. Operatori ekonomik paraqet kërkesën pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për t'u pajisur me autorizim për importin, eksportin, transitin e artikujve piroteknikë dhe licencë të importit, eksportit ose prodhimit, me shkrim ose nëpërmjet platformave *online*, të shoqëruar me dokumentacionin e plotë, të përcaktuar në kreun II, të këtij vendimi.

2. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, pas marrjes në shqyrtim të kërkesës nga operatori ekonomik, verifikimit të dokumentacionit, të përcaktuar në kreun II dhe plotësimit të kushteve, të përcaktuara në kreun I, të këtij vendimi, vendos miratimin, refuzimin apo i kërkon operatorit ekonomik të plotësojë mangësitë e konstatuara.

3. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vendos refuzimin e kërkesës për pajisje me licencë importi apo eksporti, në rastet kur:

a) administratori dhe ortaku nuk gëzon besueshmërinë për ushtrimin e aktivitetit me lëndët piroteknike, i provuar nëpërmjet vërtetimit të besueshmërisë, lëshuar nga struktura përgjegjëse në Policinë e Shtetit;

b) operatori ekonomik dhe administratori janë në proces gjyqësor penal;

c) operatori ekonomik dhe administratori janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë.

4. Në rastet kur Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve gjatë shqyrtimit të dosjeve konstaton mangësi të dokumentacionit, të parashikuar në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të kreut II, nga ana e operatorit ekonomik i kërkon atij me shkresë plotësimin e tyre. Operatori ekonomik ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të plotësuar mangësitë e konstatuara, në të kundërt kërkesa do të konsiderohet e refuzuar. Për këtë do të njoftohet me shkrim, nëpërmjet platformës *online*, operatori ekonomik.

5. Në çdo rast, para lëshimit të licencës së prodhimit, si dhe gjatë vlefshmërisë së saj kur konstatohen ndryshime, të cilat synojnë të prekin procesin teknologjik të prodhimit (makineri,



objekte, produkt), Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve propozon që, me urdhër të ministrit përgjegjës për mbrojtjen, të caktohen ekspertë të fushës nga Forcat e Armatosura për verifikimin e kushteve dhe kriterëve, të përcaktuara në këtë vendim.

Neni 12

Miratimi ose refuzimi i licencave

1. Miratimi ose refuzimi i licencave të importit dhe eksportit të artikujve piroteknikë jepet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me licencë, me shkrim ose nëpërmjet platformave *online*, të shoqëruar me dokumentacionin e plotë.

2. Miratimi ose refuzimi i licencës së prodhimit të artikujve piroteknikë jepet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me licencë, me shkrim ose nëpërmjet platformave *online*, të shoqëruar me dokumentacionin e plotë.

Miratimi i testimit të artikujve piroteknikë pezullon afatet e shqyrtimit të subjektit për licencën e prodhimit.

3. Miratimi ose refuzimi i autorizimeve për importin, eksportin, transitin e artikujve piroteknikë jepet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me autorizim, me shkrim ose nëpërmjet platformave *online*, të shoqëruar me dokumentacionin e plotë.

4. Për çdo ndryshim që mund të bëjë operatori ekonomik, pas marrjes së licencës në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, duhet të njoftojë, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. Ndryshimet e kërkuara duhet të miratohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve me të njëjtën procedurë shqyrtimi si ajo e miratimit të licencës. Në rast se ndryshimet e kërkuara nuk përputhen me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, licenca apo autorizimi i lëshuar shfuqizohet.

KREU IV

AFATI I VLEFSHMËRISË SË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE DETYRIMET E OPERATORIT EKONOMIK

Neni 13

Afatet e licencimit dhe vlefshmërisë

1. Afati i vlefshmërisë së licencës për importin dhe eksportin e artikujve piroteknikë është 5-vjeçar.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës për prodhimin e artikujve piroteknikë është 8-vjeçar.

3. Afati i vlefshmërisë së autorizimeve për importin, eksportin dhe transitin e artikujve piroteknikë është 1-vjeçar.

Neni 14

Detyrimet e operatorit ekonomik

1. Operatori ekonomik, i pajisur me licencë importi ose eksporti, duhet që të dërgojë pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve deklaratë vjetore, të shoqëruar me një pasqyrë për sasinë në gjendje të artikujve piroteknikë, brenda datës 15 janar të çdo viti.

2. Operatori ekonomik, i pajisur me licencë prodhimi, duhet të raportojë pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për:

a) sasinë e mallit të prodhuar çdo fund muaji;

b) deklaratën vjetore, të shoqëruar me një pasqyrë për sasinë në gjendje të artikujve piroteknikë, brenda datës 15 janar, të vitit pasardhës.

3. Operatori ekonomik, i licencuar për prodhimin e artikujve piroteknikë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë duhet të përmbushë këto detyrime:

a) Informon për probleme që lidhen me veprimtarinë e prodhimit të artikujve piroteknikë autoritetin licencues ose autoritetet e tjera shtetërore, që kanë kompetenca për kontrollin e kësaj veprimtarie;

b) Përmbush, brenda afateve, detyrat e lëna pas inspektimit nga autoriteti licencues dhe autoritetet shtetërore që kanë kompetenca për kontrollin e kësaj veprimtarie;

c) Harton dhe afishon në mënyrë të dukshme skemat për reagimin ndaj situatave emergjente dhe parashikon plane të veçanta për përballimin e tyre;

ç) Lajmëron autoritetin licencues për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me drejtuesit teknikë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga zgjidhja e kontratës së



punës dhe zëvendëson drejtuesin teknik, brenda një periudhe kohore prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Për marrjen në shqyrtim të këtij ndryshimi ndiqet e njëjta procedurë si ajo e pajisjes me licencë të subjektit. Në rast se drejtuesi teknik nuk plotëson kushtet e përcaktuara në këtë vendim, licenca apo autorizimi i lëshuar shfuqizohet.

4. Operatori ekonomik i pajisur me autorizim për import, eksport ose transit, duhet që:

a) për çdo transferim të mallit të njoftojë 24 (njëzet e katër) orë përpara mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë ose dërgimit, me anën e një vetëdeklarimi, Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, për sasinë që do të importojë, do të eksportojë ose do të transitojë;

b) të dërgojë pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dokumentet e importit, eksportit ose transimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e lëvrimit, të shoqëruara me deklaratat doganore.

KREU V PROCEDURAT E SHFUQIZIMIT DHE PEZULLIMIT TË LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE

Neni 15

Procedura e shfuqizimit dhe pezullimit të licencave dhe autorizimeve

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vendos marrjen e masave administrative me gjobë, me pezullim ose shfuqizim të licencës apo autorizimit, sipas rasteve të përcaktuara në nenin 33, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknike”.

2. Në rastet e pezullimit të licencës apo autorizimit, operatorit ekonomik i lihet një afat 6-mujor për plotësimin e mangësive të konstatuara. Në përfundim të këtij afati, në rast të mosplotësimit të mangësive, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vendos për shfuqizimin e licencës ose autorizimit.

Neni 16

Ankimimi ndaj vendimeve të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve

1. Vendimet e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve mund të ankimohen te ministri

përgjegjës për mbrojtjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni.

2. Ministri përgjegjës për mbrojtjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankimit, vendos për lënien në fuqi, ndryshimin ose shfuqizimin e vendimit të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

3. Ndaj vendimit të ministrit përgjegjës për mbrojtjen mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e marrjes dijeni.

Neni 17

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve bashkëpunon me institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknike”, si dhe kërkon, pranon dhe u jep atyre zyrtarisht informacion për operatorët ekonomikë që paraqesin kërkesat për pajisjet me licencë apo autorizim pranë tij, sipas fushave të përgjegjësisë.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18

1. Formularët e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me licencë dhe autorizim, formati i raportimeve, si dhe modelet standarde të licencave dhe autorizimeve, miratohen me urdhër të titullarit të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

2. Vendimi nr. 932, datë 18.11.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurën për dhënien e licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Licencat dhe autorizimet e dhëna publikohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

4. Ngarkohen Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 510, datë 30.8.2023****PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DITORE
TË PËRFITIMIT DHE PROCEDURËS SË
KOMPENSIMIT PËR STREHIM PËR
PUNONJËSIT E GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e masës ditore të përfitimit dhe procedurës së kompensimit për strehim për punonjësit e nivelit të mesëm e të lartë të Gardës së Republikës, të cilët emërohen ose transferohen në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm dhe nuk u sigurohet nga Garda mjedisi për akomodim.

2. Kur punonjësi nuk ka në ngarkim persona të tjerë familjarë, me të cilët zhvendoset jashtë vendbanimit të përhershëm, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 30 m² neto. Për çdo person familjar shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10 m².

3. Numri i personave, pjesëtarë të familjes, në ngarkim të punonjësit të Gardës së Republikës vërtetohet nëpërmjet certifikatës familjare, në momentin e emërimit ose transferimit.

4. Garda e Republikës bën kompensimin e qirasë së banesës së punonjësit, përkundrejt paraqitjes së kontratës së noterizuar të qirasë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Në kontratë përcaktohet qartë adresa ku ndodhet ndërtesa, sipërfaqja në metër katror dhe vlera mujore e qirasë së objektit.

5. Masa ditore e përfitimit të kompensimit për strehim do të jetë sa 1/30 e vlerës minimale të qirasë mujore, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 469, datë 3.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

6. Punonjësi i Gardës së Republikës, që përfiton kompensim për qira banese, paraqet pranë sektorit të burimeve njerëzore dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesën me shkrim për kompensimin e qirasë së banesës;

b) fotokopjen e kartës së identitetit;

c) certifikatën personale dhe certifikatën familjare;

ç) kontratën e noterizuar të qirasë së banesës ku është transferuar;

d) vërtetimin nga Drejtoria Vendore e ASHK-së se ai ose pjesëtarët e familjes, që ka në certifikatën e gjendjes familjare, nuk kanë banesë apo nuk kanë aplikuar për legalizim banese, në juridiksionin ku është emëruar ose transferuar.

7. Verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësi dhe përlogaritja e shumës së përfitimit të kompensimit të qirasë së banesës bëhet nga komisioni, me këtë përbërje:

a) drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse;

b) shefi i sektorit të burimeve njerëzore;

c) shefi i sektorit të buxhet-financës;

ç) specialisti i infrastrukturës;

d) specialisti jurist.

8. Sektori i burimeve njerëzore njofton komisionin për paraqitjen e dokumentacionit nga punonjësi. Komisioni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e dokumentacionit, bën vlerësimin e tij dhe në rast të pranimin të kërkesës bën përlogaritjen e shumës së përfitimit të kompensimit të qirasë së banesës. Komisioni merr vendim me shumicë, në prani të të gjithë anëtarëve të tij. Në bazë të vendimit të komisionit, drejtori i përgjithshëm nxjerr urdhrin për kompensimin e qirasë së banesës për punonjësin.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



VENDIM
Nr. 511, datë 30.8.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE PROCEDURAVE PËR
TRANSFERIMIN E PUNONJËSVE TË
GARDËS SË REPUBLIKËS NË
STRUKTURA TË TJERA ME GRADË, NË
VARËSI TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE
PËR RENDIN DHE SIGURINË PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e Gardës së Republikës mund të transferohen, për arsye shërbimi, në struktura të tjera me gradë, në varësi të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, me kërkesën e këtyre të fundit.

2. Punonjësit, të cilët transferohen në struktura të tjera me gradë, emërohen në funksion në nivel ekuivalent me gradën që kanë.

3. Titullarët e institucioneve kërkuese, të cilët shprehin interes për emërimin e punonjësve të Gardës së Republikës në strukturat e tyre, paraqesin kërkesën me shkrim pranë drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës, duke specifikuar kriteret dhe kualifikimin që duhet për të kryer detyrën.

4. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës, për çdo funksion të kërkuar nga institucionet kërkuese, përzgjedh kandidaturën që plotëson kriteret e kërkuara dhe e përcjell atë tek institucioni kërkues, së bashku me dokumentacionin që vërteton kualifikimin e tij për pozicionin e propozuar.

5. Kur kandidatura e përzgjedhur mban gradën “Drejtues i lartë”, transferimi bëhet me urdhër të ministrit, pas propozimit të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës.

6. Institucioni kërkues, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kandidaturës së propozuar, sipas pikave 4 dhe 5, të këtij vendimi, shprehet me shkrim për pranimin ose jo të tij.

7. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës, pas marrjes së dakordësisë, nxjerr urdhrin e transferimit të punonjësit dhe ia përcjell atë

institucionit kërkues, së bashku me dosjen personale.

8. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës ka të drejtë që për nevoja pune të kërkojë rikthimin e punonjësit në Gardën e Republikës, para plotësimit të afatit të transferimit, por jo më parë se 6 (gjashtë) muaj nga transferimi.

9. Punonjësi i transferuar pranë strukturave/institucioneve të tjera me gradë, në varësi të ministrisë, sipas këtij vendimi, në përfundim të periudhës së qëndrimit në detyrë, ka të drejtë të rikthehet në strukturat e Gardës në një funksion, në përputhje me gradën që mban aktualisht.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Garda e Republikës, Policia e Shtetit dhe strukturat e tjera me gradë në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 512, datë 30.8.2023

**PËR NGARKIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT SI ORGAN QENDROR
BLERËS, PËR REALIZIMIN E
KONKURSIT TË PROJEKTIMIT PËR
PROJEKTIDETË E ZHVILLIMIT TË
TIRANA EXPO DHE PËR NJË SHITESË
FONDI NË BUXHETIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT, MIRATUAR PËR
VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e zhvillimit të *Tirana Expo*, një hapësirë fleksibël për ekspozita, panaire, koncerte, takime, evenimente, rekreacion dhe logjistikë.

2. Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, t'i shtohet fondi prej 23 705 000 (njëzet e tre milionë e shtatëqind e pesë mijë) lekësh, në zërin "Shpenzime korrente", për përballimin e shpenzimeve për realizimin e procedurave të prokurimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Efekti financiar, prej 23 705 000 (njëzet e tre milionë e shtatëqind e pesë mijë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 513, datë 30.8.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 662, DATË 8.10.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE, PËR HAPJEN DHE
PËR MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE
ARSIMORE PARAUNIVERSITARE
PUBLIKE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 23, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

I. Në vendimin nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit, fjalët "... qeverisjes vendore ..." zëvendësohen me "... vetëqeverisje vendore ..." dhe fjalët "... njësia arsimore përkatëse vendore ..." zëvendësohen me "... zyra vendore e arsimit parauniversitar përkatëse ...".

2. Në pikën 1, të nënkreut A, të kreut I, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalët "... për herë të parë e njërit prej institucioneve ..." zëvendësohen me "... të institucioneve ...";

b) Pas shkronjës "b" shtohet shkronja "b/1", me këtë përmbajtje:

"b/1) Shkollë e arsimit bazë;"

3. Në pikën 7, të nënkreut A, të kreut I, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronjat "ç", "dh" dhe "e" ndryshohen, si më poshtë vijon:

"ç) Infrastruktura është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, që plotëson standardet sipas legjislacionit në fuqi;

dh) Deklarimin për përmbushjen e standardeve të përgjithshme, të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, lidhur me ngarkesën mësimore të mësuesve;

e) Deklarimin për plotësimin e kriterëve profesionale për drejtuesin dhe personelin mësimor, sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi."

b) Pas shkronjës "e" shtohet shkronja "ë", me këtë përmbajtje:

"ë) Plotëson standardet që lidhen me kurrikulën mësimore, të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin."

4. Pas nënkreut B, të kreut I, shtohet nënkreu C, me këtë përmbajtje:

**"C. HAPJA DHE MBYLLJA E SHKOLLAVE
TË BASHKUARA**

1. Në kuptim të këtij vendimi, "Hapja e shkollave të bashkuara" është procesi i hapjes së një institucioni arsimor parauniversitar publik, ku përfshihen nxënës, sipas përcaktimeve në nenin 24/1, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.



2. Hapja e shkollave të bashkuara realizohet nëpërmjet bashkimit apo ndarjes së disa institucioneve arsimore parauniversitare publike, të përcaktuara në pikën 1, të nënkreut A, të kreut I, të këtij vendimi. Ky proces iniciohet me kërkesë të njërive të vetëqeverisjes vendore ose zyrës vendore të arsimit parauniversitar mbi bazën e studimeve të argumentuara apo kërkesës/ave objektive të komunitetit të zonës, ku ushtron veprimtarinë institucioni arsimor.

3. Institucioni/et arsimor/e parauniversitar/e publik/e hapen si shkollë e bashkuar kur vlerësohet i nevojshëm:

a) përmirësimi i menaxhimit të institucionit për të përmbushur funksionet e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi;

b) bashkimi/ndarja e institucioneve arsimore parauniversitare publike për të optimizuar burimet njerëzore, financiare dhe të infrastrukturës;

c) transferimi i një institucioni arsimor publik në një zonë tjetër për ushtrimin e veprimtarisë;

d) në çdo rast tjetër, në kuadër të zbatimit të reformave në fushën e politikave të arsimit parauniversitar.

4. Shkollat e bashkuara mbyllen në rastet kur secili prej institucioneve arsimore parauniversitare publike, të përcaktuara në pikën 1, të nënkreut A, të kreut I, të këtij vendimi, që kanë qenë pjesë e shkollës së bashkuar, hapet si institucion arsimor parauniversitar më vete.

5. Vendimarrja e ministrisë përgjegjëse për arsimin bazohet në vlerësimet e kryera nga institucionet përgjegjëse në varësi të saj, të nevojave për hapjen apo mbylljen e shkollës së bashkuar, bazuar në analizën e shtimit/pakësimit të numrit të nxënësve, kushteve social-ekonomike të zonës ku do të hapet shkolla e bashkuar, si dhe në bazë të vlerësimit të performancës dhe të plotësimit të standardeve nga institucioni arsimor parauniversitar publik.

6. Hapja dhe mbyllja e shkollave të bashkuara realizohet në përfundim të vitit shkollor.”

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 514, datë 30.8.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 359, DATË 29.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PARIMET DHE UDHËZIMET E PRAKTIKËS SË PRODHIMIT TË MIRË TË BARNAVE, PËR PËRDORIM NJERËZOR, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për parimet dhe udhëzimet e praktikës së prodhimit të mirë të barnave, për përdorim njerëzor, në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 359, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në kreun I bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Shkronja “b”, e pikës 1.5, shfuqizohet;

ii. Shkronja “b”, e pikës 1.12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Kontrata përcakton qartë përgjegjësitë e secilës palë dhe shpjegon, në veçanti, respektimin e PMF-së së barnave, që duhet të ndiqet nga pranuesi i kontratës.”;

b) Në “Fjalorin e termave”, në përkufizimin “Person i kualifikuar”, në shkronjën “b”, togfjalëshi “... të paktën dy vjet ...” zëvendësohet me “... jo më pak se 5 vjet ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 516, datë 30.8.2023****PËR TRANSFERIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË TE
FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË
PASURISË SË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NR. 10/46, ISH-
MATERNITETI SARANDË, NË ZONËN
KADASTRALE 8641**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Fondi

Shqiptar i Zhvillimit, të pasurisë shtetërore nr. 10/46, me sipërfaqe 1 842.26 (një mijë e tetëqind e dyzet e dy pikë njëzet e gjashtë) m², e llojit “truall”, nga e cila 1 017.46 (një mijë e shtatëmbëdhjetë pikë dyzet e gjashtë) m², ndërtesë, në zonën kadastrale 8641, me emërtimin “Ish-Materniteti” Sarandë, sipas kartelës së pasurisë dhe fragmentit të hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim rikonstruksionin dhe vënien në shfrytëzim si destinacion i ri turistik me hapësira multifunksionale, si: muzeale, atraktive dhe edukuese.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8641032154

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8641, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 10/46, Sipërfaqja Totale 1819.76 m²,
(Nga të Cilat Truall 1819.76 m²; Ndërtesë 1198.5 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale SR; E-9, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia Dropull, Rruga Vrisera, Ndërtesa Nr. 137, SH/K 0, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISE, Nr. Identifikimi/NIPT SG27069769100, Pjesa Takuese 1/1,

Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. 00018416, Datë: 15/07/2019

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/NIPT
00018416	15/07/2019		ME VKM NR. 401 DATE 19/06/2019 KJO PASURI KALON NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI TE INSTITUTIT TE SIGURIMEVE SHOQERORE			0		

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____, Emërtimi i Aktit: ____, Nr. __, Datë: ____

Regjistruar: Nr. __, Datë: ____

Përshkrimi: MATERNITETI 7278

DREJTORI
Aida Demi

Albjona
Rexho

Digitally signed by:
Albjona Rexho
Date: 2023.08.24
02:52:55 +02'00'

Aida
Demi

Digitally signed by:
Aida Demi
Date: 2023.08.24
04:29:13 +02'00'

Data e lëshimit 24/08/2023



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Sarandë
Date: 2023/08/24 14:51:59 +02'00'
J62325010W2023082414515274ASHK

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 8641

KODI UNIK: 8641032154

NUMRI I PASURISË: 10/46

INDEKSI I HARTËS: SR; E-9

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



DREJTORI

Aida
Demi

Digitally signed by Aida Demi
Date: 2023.08.24 16:40:33
+02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Sarandë
Date: 2023/08/24 16:40:03 +02'00'
DS0226005A2023082416395637014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Sarandë)

SHpjegues

- ☐ PARCELA
- ☐ NDËRTESA



UDHËZIM

Nr. 2, datë 1.2.2023

**PËR ELEMENTET, KËRKESAT DHE
PARIMET E PËRGJITHSHME TË
ANALIZËS SË KOSTOS DHE
PËRFITIMIT, PËR VLERËSIMIN E
POTENCIALIT TË APLIKIMIT TË
KOGJENERIMIT ME EFIÇENCË TË
LARTË, SI DHE TË NGROHJES E
FTOHJES EFIÇENTE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 15/1, pika 1, të ligjit nr. 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Vlerësimi në nivel kombëtar i potencialit për përdorimin e kogjenerimit me efikasitet të lartë, si dhe të ngrohjes dhe ftohjes efikente në sistemet qendrore realizohet nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë.

2. Studimi përfshin realizimin e analizës së kostos dhe përfitimit në të paktën 30% të njërive të vetëqeverisjes vendore, në varësi të burimeve energjetike të disponueshme dhe zonës klimatike.

3. Studimi realizohet në një mënyrë të tillë që të përfshihen të gjitha tipologjitë e ndërtesave të përcaktuara në vendimin nr. 1094, datë 24.12.2020, “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa”. Në studim të mos konsiderohen ato ndërtesa që përjashtohen nga detyrimet për plotësimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë sipas legjislacionit në fuqi.

4. Për realizimin e vlerësimit agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë duhet të shfrytëzojë parimet e përgjithshme për llogaritjen e energjisë elektrike nga kogjenerimi, të paraqitura në shtojcën I dhe metodologjinë për përcaktimin e efikasitetit së proceseve të kogjenerimit sipas shtojcës II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuara në ligjin nr. 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”, i ndryshuar, , ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Sisteme qendrore” – janë sisteme të përbashkëta të cilat furnizojnë me energji termike,

përmes një rrjeti tubacionesh, disa apartamente ose disa ndërtesa në të njëjtën kohë;

b) “Pikë reference” – është një tregues i fiksuar i cili përdoret për qëllime krahasimi;

c) “Kogjenerimi” – është gjenerimi në të njëjtën kohë i energjisë termike dhe elektrike, nga një proces.

6. Vlerësimi gjithëpërfshirës i potencialit kombëtar të ngrohjes dhe ftohjes duhet të përfshijë:

a) një përshkrim të kërkesës për ngrohje dhe ftohje;

b) një parashikim se si kjo kërkesë do të ndryshojë në 10 vitet e ardhshme, duke marrë parasysh në mënyrë të veçantë evolucionin e kërkesës për ngrohje dhe ftohje në ndërtesa dhe sektorë të ndryshëm të industrisë;

c) një hartë të territorit kombëtar, duke ruajtur informacionin e ndjeshëm tregtar dhe duke identifikuar:

i. pikat e kërkesës për ngrohje dhe ftohje, duke përfshirë:

- bashkitë; dhe

- zonat industriale me konsum të përgjithshëm vjetor për ngrohje dhe ftohje më shumë se 20 gwh;

ii. infrastrukturën ekzistuese dhe të planifikuar të ngrohjes dhe ftohjes qendrore;

iii. pikat e mundshme të furnizimit me ngrohje dhe ftohje, duke përfshirë:

- impiantet termike të prodhimit të energjisë elektrike me një prodhim total vjetor të energjisë elektrike më shumë se 20 gwh; dhe

- impiantet e djegies së mbetjeve urbane;

- instalimet ekzistuese dhe të planifikuara të kogjenerimit dhe instalimet e ngrohjes qendrore;

d) identifikimi i kërkesës për ngrohje dhe ftohje që mund të plotësohet nga kogjenerimi me efikasitet të lartë, duke përfshirë mikro-kogjenerimin rezidencial, nga ngrohja dhe ftohja qendrore;

e) identifikimin e potencialit për kogjenerimin shtesë me efikasitet të lartë, duke përfshirë rinovimet e impianteve ekzistuese dhe ndërtimin e impianteve të reja, dhe instalimeve industriale ose objekteve të tjera që gjenerojnë nxehtësi e cila emetohet në ambient dhe nuk shfrytëzohet;

f) identifikimin e potencialit të efikasitetit së infrastrukturës së ngrohjes dhe ftohjes qendrore;

g) strategjitë, politikat dhe masat që mund të miratohen për të realizuar potencialin në shkronjën “e”, të pikës 6, të këtij udhëzimi, në mënyrë që të



plotësohet kërkesa në shkronjën “d”, të pikës 6, të këtij udhëzimi, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, propozime për:

i. rritjen e kontributit të kogjenerimit në gjenerimin e ngrohjes dhe ftohjes, si dhe në prodhimin e energjisë elektrike;

ii. zhvillimin e infrastrukturës eficiente të ngrohjes dhe ftohjes qendrore për të akomoduar zhvillimin e kogjenerimit me efikasitet të lartë dhe përdorimin e ngrohjes dhe ftohjes nga nxehtësia e pashfrytëzuar dhe burimet e rinovueshme të energjisë;

iii. të inkurajuar që instalimet e reja termike për prodhimin e energjisë elektrike dhe impianteve industriale që gjenerojnë nxehtësi të pozicionohen në vende ku një sasi maksimale e nxehtësisë së pashfrytëzuar të rikuperohet për të përmbushur kërkesat ekzistuese ose ato të parashikuara për ngrohje dhe ftohje;

iv. të inkurajuar zona të reja rezidenciale ose impiante të reja industriale që konsumojnë nxehtësi në proceset e tyre të prodhimit të pozicionohen aty ku mund të kontribuojë nxehtësia e pashfrytëzuar e impianteve të tjera, për përmbushjen e kërkesave të tyre për ngrohje dhe ftohje. Kjo mund të përfshijë propozime që mbështesin grumbullimin e një numri instalimesh individuale në të njëjtin vend, me synimin për të siguruar një përputhje optimale ndërmjet kërkesës dhe ofertës për ngrohje dhe ftohje;

v. të inkurajuar impiantet termike të gjenerimit të energjisë elektrike, impiantet industriale që prodhojnë nxehtësi e cila nuk shfrytëzohet, inceneratorë dhe impiante të tjera të këtij lloji, për t'u lidhur me rrjetin lokal të ngrohjes ose ftohjes qendrore;

vi. të inkurajuar zonat e banuara dhe impiantet industriale që konsumojnë nxehtësi në proceset e tyre të prodhimit për t'u lidhur me rrjetin lokal të ngrohjes ose ftohjes qendrore.

h) kontributin e kogjenerimit me efikasitet të lartë dhe potencialin, dhe progresin e arritur;

i) një vlerësim të energjisë primare që do të kursethet;

j) një vlerësim të masave të mbështetjes publike për ngrohjen dhe ftohjen, nëse ka, me buxhetin vjetor dhe identifikimin e instrumenteve mbështetëse publike, ose ndihmës shtetërore.

7. Analiza kosto-përfitim duhet të përfshijë një vlerësim në nivel kombëtar në mënyrë që të vendoset opsioni më kosto-efektiv dhe më i

dobishëm për ngrohjen ose ftohjen, për një zonë të caktuar gjeografike, me qëllim planifikimin e ngrohjes dhe ftohjes eficiente.

8. Analiza kosto-përfitim duhet të përfshijë një analizë ekonomike që mbulon faktorët socio-ekonomik dhe ato mjedisor.

9. Analiza kosto-përfitim duhet të përfshijë elementet dhe kërkesat e mëposhtme:

a) Përcaktimin e kufijve të sistemit, si dhe shtrirjes gjeografike:

i. realizimi i analizave kosto-përfitim përcakton sistemin më të përshtatshëm energjetik. Kufiri gjeografik duhet të mbulojë një zonë të përshtatshme gjeografike të mirëpërcaktuar, p.sh.: një rajon, bashki ose zonë metropolitane të caktuar, me qëllim të shmangies së zgjedhjeve të nënoptimizuara për secilin projekt;

b) Integrimin e mundësive të plotësimit të kërkesës për energji dhe burimeve energjetike:

i. analiza kosto-përfitim do të marrë parasysh të gjitha burimet përkatëse të furnizimit në dispozicion brenda sistemit dhe kufirit gjeografik, duke përdorur të dhënat e disponueshme, duke përfshirë nxehtësinë e çliruar nga prodhimi i energjisë elektrike dhe instalimet industriale, dhe energjinë e rinovueshme, si dhe karakteristikat dhe tendencat në kërkesën për ngrohje dhe ftohje;

c) Përcaktimi i një pike reference;

d) Identifikimi i skenarëve alternativë:

i. të gjitha alternativat e përshtatshme respektivisht pikës së referencës duhet të merren parasysh. Skenarët që nuk janë të realizueshëm për arsye teknike, arsye financiare, rregullore kombëtare ose kufizime kohore mund të përjashtohen në një fazë të hershme të analizës kosto-përfitim nëse justifikohen bazuar në konsiderata të kujdesshme, të qarta dhe të mirë dokumentuara;

ii. në analizën kosto-përfitim duhet të merren parasysh vetëm kogjenerimi me efikasitet të lartë, ngrohje dhe ftohje qendrore eficiente ose opsione të tjera eficiente të furnizimit me ngrohje dhe ftohje individuale, si skenarë alternativë krahasuar me pikën referencë;

e) Metoda për llogaritjen e tepicës kosto-përfitim:

i. të vlerësohen dhe krahasohen kostot dhe përfitimet totale afatgjata të opsioneve të furnizimit me ngrohje ose ftohje;

ii. kriteri për vlerësim do të jetë sipas vlerës aktuale neto (NPV);



iii. jetëgjatësia e sistemeve do të zgjidhet në mënyrë të tillë që të përfshihen të gjitha kostot dhe përfitimet përkatëse sipas skenarëve. Për shembull, për një termocentral me gaz, jetëgjatësia e përzgjedhur të mos jetë më shumë se 25 vjet, për një sistem ngrohje–ftohje qendrore, jo më shumë se 30 vjet, ose për pajisjet e ngrohjes si kalaja jo më shumë se 20 vjet;

f) Llogaritja dhe parashikimi i çmimeve, si dhe supozime të tjera për analizën ekonomike:

i. agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë identifikon çmimet e faktorëve kryesorë që shërbejnë si “inpute” dhe “outpute”, për qëllim të realizimit të analizës kosto-përfitim, si dhe normën e skontimit;

ii. norma e skontimit, e përdorur në analizën ekonomike për llogaritjen e vlerës aktuale neto, do të zgjidhet sipas udhëzimeve kombëtare ose evropiane;

iii. për realizimin e analizës kosto-përfitim do të përdoren parashikimet kombëtare, evropiane ose ndërkombëtare të zhvillimit të çmimeve të energjisë;

iv. çmimet e përdorura në analizën ekonomike duhet të pasqyrojnë kostot dhe përfitimet e vërteta socio-ekonomike, dhe duhet të përfshijnë kostot e jashtme, të tilla si efektet mjedisore dhe shëndetësore, për aq sa është e mundur, d.m.th. kur ekziston një çmim tregu ose kur ai tashmë është përfshirë në një rregullore kombëtare ose evropiane;

g) Analiza ekonomike: Inventari i efekteve:

i. analizat ekonomike do të marrin parasysh të gjitha efektet përkatëse ekonomike;

ii. procesi i analizës ekonomike duhet të marrë parasysh gjatë vendimmarrjes kostot dhe kursimet e energjisë nga rritja e fleksibilitetit në furnizimin me energji, dhe nga një funksionim më optimal i rrjeteve të energjisë elektrike, duke përfshirë kostot e shmangura dhe kursimet nga reduktimi i investimeve në infrastrukturë, bazuar në skenarët e analizuar;

Kostot dhe përfitimet e marra parasysh do të përfshijnë të paktën sa vijon:

Përfitimet:

i. Sasia e prodhimit për konsumatorin (nxehësia dhe/ose energjia elektrike);

ii. Përfitime të jashtme, siç janë përfitimet mjedisore dhe shëndetësore, për aq sa është e mundur.

Kostot:

i. Kostot kapitale të centraleve ose pajisjeve;

ii. Kostot kapitale për zhvillimin e rrjetit energjetik;

iii. Kostot operacionale fikse dhe variabël;

iv. Kostot e energjisë;

v. Kostot mjedisore dhe shëndetësore, për aq sa është e mundur;

h) Analiza e ndjeshmërisë:

i. një analizë e ndjeshmërisë do të përfshihet për të vlerësuar kostot dhe përfitimet e një projekti ose grupi projektsh bazuar në çmime të ndryshme të energjisë, norma skontimi dhe faktorë të tjerë të ndryshueshëm që kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatin e llogaritjeve.

10. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë dërgon studimin e përgatitur tek ministria përgjegjëse për energjinë, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

11. Ngarkohet agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

SHTOJCA I
PARIMET E PËRGJITHSHME PËR
LLOGARITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA KOGJENERIMI

1. Vlerat e përdorura për llogaritjen e energjisë elektrike nga kogjenerimi përcaktohen në bazë të operimit të prirur apo aktual të njësisë në kushte normale përdorimi. Për njësi të mikro-kogjenerimit, llogaritja mund të bazohet në vlera të certifikuara.

a) Prodhimi i energjisë elektrike nga kogjenerimi konsiderohet i barabartë me totalin e prodhimit vjetor të energjisë elektrike të njësisë së matur në dalje të gjeneratorëve kryesorë;

i. në njësitë e kogjenerimit të llojeve “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “h”, referuar në pikën 2 të kësaj shtojce me efikasitet të përgjithshëm vjetor në një nivel prej së paku 75%; dhe



ii. në njësitë e kogjenerimit të llojeve “a” dhe “c”, referuar në pikën 2 të kësaj shtojce, me efikasitet të përgjithshme vjetore në një nivel prej së paku 80%.

b) Në njësitë e kogjenerimit me efikasitet të përgjithshme vjetore nën vlerën e referuar në pikën “i”, të pikës “a” ose me një efikasitet të përgjithshme vjetore nën vlerën e referuar në pikën “ii”, të pikës “a”, kogjenerimi llogaritet sipas formulës në vijim:

$$E_{CHP} = H_{CHP} * C$$

ku:

E_{CHP} – është sasia e energjisë elektrike nga kogjenerimi;

C – është raporti energji elektrike–nxehtësi;

H_{CHP} – është shuma e nxehtësisë së dobishme nga kogjenerimi (e llogaritur për këtë qëllim si prodhimi total i nxehtësisë minus çdo lloj nxehtësie e prodhuar në kaldaja të veçanta ose nga ekstraktimi i avullit nga gjeneratori i avullit, përpara turbinës);

iii. Llogaritja e energjisë elektrike nga kogjenerimi duhet të bazohet në raportin aktual të energjisë elektrike ndaj nxehtësisë. Në qoftë se raporti aktual energji elektrike–nxehtësi nga një njësi kogjenerimi është i panjohur, mund të përdoren vlerat e mëposhtme të parazgjedhura, në veçanti për qëllime statistikore, për njësitë e llojeve sipas pikave “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”, referuar në pikën 2 të kësaj shtojce, me kusht që kogjenerimi i llogaritur i energjisë elektrike është më pak apo i barabartë me prodhimin total të energjisë elektrike:

Lloji i njësisë	C
Turbina me gaz me cikël të kombinuar me rikuperim të nxehtësisë	0.95
Turbinë avullit me kundërpresion	0.45
Turbinë me ekstraktim të avullit të kondensuar	0.45
Turbinë gazi me rikuperim nxehtësie	0.55
Motor me djegie të brendshme	0.75

iv. Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë, me propozimin e agjencisë për efikasitet të energjisë mund të miratojë vlerat e parazgjedhura për raportet energji elektrike–nxehtësi për llojet e njësisë, sipas pikave “f”, “g”, “h”, “i”, “j” dhe “k”, të paraqitura në pikën 2 në vijim. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë njoftohet për vlerat e parazgjedhura;

c) Nëse një pjesë e përmbajtjes së energjisë nga inputi i lëndëve djegëse në procesin e kogjenerimit rikupërohet në kimikate dhe riciklim, kjo pjesë

mund të zbritet nga inputi i lëndëve djegëse para llogaritjes së efikasitetit të përgjithshme;

d) Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë mund të përcaktojë raportin energji elektrike–nxehtësi, si raport i energjisë elektrike ndaj nxehtësisë së dobishme kur operohet në modalitetin e kogjenerimit me kapacitet më të ulët, duke përdorur të dhënat operative të njësisë specifike.

2. Teknologjitë e kogjenerimit janë:

a) turbina me gaz me cikël të kombinuar me rikuperim nxehtësie;

b) turbinë avullit me kundërpresion;

c) turbinë me nxjerrje të avullit të kondensuar;

d) turbina gazi me rikuperim nxehtësie;

e) motor me djegie të brendshme;

f) mikroturbinat

g) motor *stirling*;

h) qelizat e karburantit;

i) motor me avull;

j) turbina me cikël rankin organik;

k) çdo lloj tjetër teknologjie ose kombinim i tyre, sipas përkufizimit në pikën 5, shkronja “c”.

SHTOJCA II METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E EFIKASITETIT NGA PROCESI I KOGJENERIMIT

Vlerat e përdorura për llogaritjen e efikasitetit të energjisë primare përcaktohen në bazë të funksionimit të pritshëm ose aktual të njësisë në kushte normale përdorimi.

a) Kogjenerimi me efikasitet të lartë duhet të përmbushë këto kritere:

- Prodhimi nga njësitë e kogjenerimit duhet të sigurojë kursim të energjisë primare të llogaritur sipas pikës “b”, prej të paktën 10%, në krahasim me referencat për prodhimin e veçantë të energjisë termike dhe energjisë elektrike;

- Prodhimi nga njësitë e vogla të kogjenerimit duhet të sigurojnë kursim të energjisë primare dhe mund të kualifikohen si kogjenerim me efikasitet të lartë.

b) Sasia e kursimit të energjisë primare që sigurohet nga kogjenerimi përcaktohet në përputhje me parimet e përgjithshme për llogaritjen e energjisë elektrike nga kogjenerimi dhe llogaritet në bazë të kësaj formule:



$$PES = \left[\frac{1}{\frac{CHP H\eta}{Ref H\eta} + \frac{CHP E\eta}{Ref E\eta}} \right] * 100\%$$

ku:

PES – është kursimi i energjisë primare;

CHP H η – është efienca e energjisë termike nga kogjenerimi, që përkufizohet si prodhim vjetor i dobishëm i energjisë termike pjesëtuar me inputin e lëndës djegëse që përdoret për të prodhuar shumën e prodhimit të dobishëm të energjisë termike dhe energjisë elektrike nga kogjenerimi;

Ref H η – është vlera referuese e efijencës për prodhimin e veçantë të energjisë termike;

CHP E η – është efienca e energjisë elektrike nga kogjenerimi, që përkufizohet si energjia elektrike vjetore nga kogjenerimi i pjesëtuar me inputin e lëndës djegëse për të prodhuar shumën e prodhimit të dobishëm të energjisë termike dhe energji elektrike nga kogjenerimi. Kur njësia e kogjenerimit prodhon energji mekanike, energjia elektrike vjetore nga kogjenerimi mund të rritet me një element shtesë që paraqet shumën e energjisë elektrike që është e barabartë me atë të energjisë mekanike. Ky element shtesë nuk krijon të drejtën për të nxjerrë garanci të origjinës;

Ref E η është vlera referuese e efijencës për prodhimin e veçantë të energjisë elektrike.

c) Mund të përdoren llogaritje alternative të kursimit të energjisë primare nga prodhimi i energjisë termike, energjisë elektrike dhe energjisë mekanike, siç përcaktohet në paragrafin e mëposhtëm, pa i zbatuar parimet e përgjithshme për llogaritjen e energjisë elektrike nga kogjenerimi për të përjashtuar pjesët e energjisë termike dhe energjisë elektrike të cilat nuk kogjenerohen nga i njëjti proces;

d) Prodhimi, sipas paragrafit 4 të këtij neni, mund të konsiderohet si kogjenerim me efijencë të lartë me kusht, nëse i plotëson kriteret e efijencës nga paragrafi 2 i këtij neni, ndërsa, për njësitë e kogjenerimit me kapacitet elektrik më të madh se 25 mw, efienca e përgjithshme është mbi 70%. Specifikimi i sasisë së energjisë elektrike nga kogjenerimi i prodhuar në një prodhim të tillë, për nxjerrjen e garancisë së origjinës dhe për qëllime statistikore, përcaktohet në përputhje me parimet e përgjithshme për llogaritjen e energjisë elektrike nga kogjenerimi;

e) Nëse kursimi i energjisë primare për një proces llogaritet duke përdorur llogaritjen alternative, siç përcaktohet në paragrafin 4 të këtij neni, kursimi i energjisë primare llogaritet duke përdorur formulën në paragrafin 3 të këtij neni, duke zëvendësuar: “CHP H η ” me “H η ” dhe “CHP E η ” me “E η ”, ku:

- H η – nënkupton efijencën e ngrohjes që përkufizohet si prodhimi vjetor i energjisë termike pjesëtuar me inputin e lëndës djegëse që përdoret për të prodhuar shumën e prodhimit të energjisë termike dhe të energjisë elektrike;

- E η – nënkupton efijencën e energjisë elektrike të procesit që përkufizohet si prodhimi vjetor i energjisë elektrike pjesëtuar me lëndën djegëse që përdoret për të prodhuar shumën e prodhimit të energjisë termike dhe të energjisë elektrike. Kur njësia e kogjenerimit prodhon energji mekanike, energjia elektrike vjetore nga kogjenerimi mund të rritet me një element shtesë që paraqet shumën e energjisë elektrike që është e barabartë me atë të energjisë mekanike.

f) Për njësitë e mikro-kogjenerimit, llogaritja e kursimit të energjisë primare mund të bazohet në të dhëna të certifikuar;

g) Vlerat referuese të harmonizuara të efijencës për prodhimin e veçantë të energjisë termike dhe të energjisë elektrike duhet të përbehen nga një matricë e vlerave të diferencuar nga faktorët relevant, duke përfshirë vitin e ndërtimit dhe llojet e lëndës djegëse, të jenë të bazuara në një analizë të mirëdokumentuar, duke marrë parasysh të dhëna nga përdorimi operativ nën kushte reale, përzierjen e lëndës djegëse dhe kushtet klimatike, si dhe teknologjitë e aplikuara të kogjenerimit;

h) Vlerat referuese të efijencës për prodhimin e veçantë të energjisë termike dhe energjisë elektrike, në përputhje me formulën në paragrafin 3 të këtij neni, përcaktojnë efijencën operative të prodhimit të veçantë të energjisë termike dhe energjisë elektrike që kogjenerimi synon të zëvendësojë. Vlerat referuese të efijencës llogariten sipas këtyre primeve:

1. Për njësitë e kogjenerimit krahasimi me prodhimin e veçantë të energjisë elektrike bazohet në parimin që krahasohen kategoritë e lëndëve djegëse të njëjta;

2. Secila njësi e kogjenerimit krahasohet me teknologjinë më të mirë në dispozicion dhe ekonomikisht të arsyeshme për prodhim të veçantë



të energjisë termike dhe energjisë elektrike në treg në vitin e ndërtimit të asaj njësie të kogjenerimit;

3. Vlerat referuese të efikasitetit për njësitë e kogjenerimit më të vjetra se 10 vjet do të fiksohen në vlerat referuese të njërive 10-vjeçare;

4. Vlerat referuese të efikasitetit për prodhimin e veçantë të energjisë elektrike dhe të energjisë termike duhet të reflektojnë kushtet klimatike të Shqipërisë.

UDHËZIM

Nr. 9, datë 29.5.2023

PËR LLOJIN DHE PERIODICITETIN E INFORMACIONIT QË VIHET NË DISPOZICION NGA AGJENCIA PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 15, të ligjit nr. 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është informimi dhe rritja e kapaciteteve të palëve të interesuara, lidhur me mekanizmat e efikasitetit të energjisë, metodat dhe praktikën e ndryshme që shërbejnë për të rritur performancën e energjisë, përmes informimit të tyre të vazhdueshëm dhe prezantimit të praktikave më të mira të disponueshme për arritjen e objektivit kombëtar të kursimit të energjisë.

2. Agjencia për Efikasitetin e Energjisë, (në vijim AEE) është përgjegjëse për informimin në mënyrë periodike të:

- a) konsumatorëve fundorë të energjisë;
- b) konsumatorëve të mëdhenj të energjisë;
- c) institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore;
- d) shoqërive publike.

3. Për secilën palë të interesuar të përmendur në pikën 2, AEE përgatit një informacion me praktikën më të mirë mbi mekanizmat për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe metodat për rritjen e performancës së energjisë sipas aktiviteteve respektive, mundësive reale për përmirësim, si dhe përfitimet që mund të arrihen prej zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë, çdo vit, para datës 31 mars dhe publikon çdo informacion në faqen e saj zyrtare të internetit.

4. Informacioni i vendosur në dispozicion nga AEE, i cili duhet të jetë specifik për secilën palë të

interesuar dhe në përputhje me aktivitetin e tyre, përditësohet çdo vit me përmbajtje të reja.

5. Më qëllim promovimin e efikasitetit të energjisë dhe ndërgjegjësimin e palëve të interesuara, AEE duhet që të paktën një herë në vit të:

a) marrë pjesë në panairë ose ekspozita të energjisë;

b) organizojë seminare dhe fushata informuese në përputhje me aktivitetin e saj.

6. AEE publikon, në faqen e saj zyrtare të internetit, informacione mbi mekanizmat financiar dhe ligjor të efikasitetit të energjisë duke përfshirë:

a) listën e të gjithë institucioneve financiare dhe bankave të nivelit të dytë që ofrojnë mbështetje për zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë;

b) listën e të gjithë legjislacionit të miratuar për efikasitetin e energjisë;

c) informacion mbi lehtësitë fiskale të ofruara nga programe të ndryshme buxhetore;

d) informacion për përfitimin e granteve të ofruara nga organe të qeverisjes qendrore dhe vendore në nivel kombëtar, duke specifikuar dhe procedurën e aplikimit për përfitimin e tyre.

7. Para datës 30 nëntor të çdo viti, AEE publikon në faqen e saj zyrtare të internetit datat dhe agjendën përkatëse mbi trajnimet që do të organizojë gjatë vitit pasardhës për:

- a) menaxherët e energjisë;
- b) audituesit e energjisë në ndërtesa;
- c) audituesit e energjisë në industri;
- d) audituesit e energjisë në transport;
- e) punonjësit e institucioneve publike;
- f) palë të tjera të interesuara.

8. AEE raporton në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për çdo vit, para datës 30 shtator, të gjithë informacionin e vënë në dispozicion dhe aktivitetet që ka ndërmarrë për zbatimin e këtij udhëzimi.

9. Ngarkohet Agjencia për Efikasitetin e Energjisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

10. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVËNDESKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

**URDHËR****Nr. 478, datë 28.8.2023****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për ndjekjen e procedurave, për shqyrtimin dhe miratimin e shpërblimeve të sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, sipas rezultateve sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare, zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, z. Endrit Hoxha.

2. Kompetencat e deleguara, sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohen deri në shfuqizimin e tij, si

dhe me pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Endrit Hoxha, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

NJOFTIM**Nr. 13220, datë 29.8.2023****MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE**

Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen e Akteve të Terrorizmit Bërthamor, bërë në Nju Jork, më 13 prill 2005, hyn në fuqi për Republikën e Shqipërisë në datën 20 shtator 2023.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**
Gazmend Turdiu

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë